



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NPT EUROSTEEL QENDRIM E GASHI BI" të datës 05.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NPT EUROSTEEL QENDRIM E GASHI BI" të datës 05.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Mescioglu" (tutje "parashtruesi") me datë 08.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-1298-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. *"Pretendimi ynë ankimor ka të bëjë me kërkesën për Kamion me shportë ngritëse =10 metra lartësi. Sa i përket kërkesës për Kamion me shportë ju lutem na sqaroni se a pranohet kamionet/furgon me korpë për të mbuluar këtë kërkesë? Duke pas parasysh se kryhet i njejt funksion si me kamion ashtu edhe me kamionetë si dhe pasi punët do të kryhen në qytet më i përshatshme është kamioneta sesa kamioni. Gjithashtu kërkesa për kamion është shumë e rrallë për të mos thënë se nuk ka fare në Kosovë Kamion me shportë por ka vetëm Kamioneta me shportë".*

- Ky pretendim është gjetur si i bazuar për faktin që pajisjet në fjalë e kanë rolin dhe funksionin identik mes tyre. Prandaj AK do të korrigjoj dosjen e tenderit ashtu që te pjesa ku përmendet fjala "Kamion" do të shtohet "Kamion apo Kamionetë/furgon me korpë".

P.2. *"Sa i përket kërkesës për autorizim, garancion dhe katalog nga prodhuesi për poz. 141 në paramasë (fig. 44) kërkojmë nga ju si AK që të largohet kjo kërkesë (autorizimi, katalogu dhe garancioni) sepse është favorizuese duke e ul kështu konkurrencën. Produkti përkatës nuk prodhohet në Kosovë, dhe si rrjedhojë, është shumë e vështirë për operatorët lokalë të marrin autorizime apo garancione direkte nga prodhuesit jashtë vendit pasi si produkt është shumë i rrallë".*

- Ky pretendim është gjetur si i bazuar pasi që në kuptim të nenit 4.3 lidhur me nenin 17.17 të RRPP lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP, AK gjithmonë duhet të përmbahet nga kërkesat e panevojshme të cilat nuk janë të domosdoshme për të siguruar cilësinë, efikasitetin dhe/apo efektivitetin e realizimit të projektit. Në rastin konkret duhet shtuar që për pozicionin e tillë, ekzistojnë shumë pak prodhues të cilët merren me prodhimin e këtyre produkteve që e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë për OE që të sigurojnë dokumentet e kërkuara në DT. Prandaj AK do të korrigjoj dosjen e tenderit ashtu që te kërkesat ku kërkohet autorizimi, katalogu dhe garancioni për pozicionet e caktuara të paramasës, do të largohet pozicioni me nr. 141.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.